



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE

**DREJTORIA E PËRGJITHSHME E BUXHETIT
DREJTORIA E PROGRAMIMIT BUXHETOR**

UDHËZIM PLOTËSUES

Nr. 7/2 Datë 04.07.2014

**PËR PËRGATITJEN E PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM
2015-2017**

Në përputhje me Ligjin nr.9936 datë 26.06.2008 neni 27, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, Ministri i Financave:

U D H Ë Z O N:

1. Të përgjithshme

- Qëllimi i këtij udhëzimi është informimi i Njësive të Qeverisjes Qendrore mbi tavanet përfundimtare të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm, të miratuara nga Këshilli i Ministrave.
- Kërkesat e rishikuara buxhetore 2015-2017 duhet të përgatiten në zbatim të Udhëzimit nr.8 datë 29.03.2012 “Për Procedurat Standarte të Përgatitjes së Programimit Buxhetor Afatmesëm”, të Udhëzimit nr.7 datë 28.02.2014 “Për Përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2015-2017” dhe të këtij Udhëzimi Plotësues.

2. Tavanet Përfundimtare të Programit Buxhetor Afatmesëm 2015-2017

- Tavanet përfundimtare të Programit Buxhetor Afatmesëm 2015-2017 të miratuara me vendim të Këshillit të Ministrave, për çdo Njësi të Qeverisjes Qendrore, do të përcillen në momentin e miratimit të tyre.
- Të gjitha Njësitë e Qeverisjes Qendrore duhet të paraqesin **brenda datës 01 Shtator 2014** kërkesat e rishikuara buxhetore, të cilat duhet të jenë detyrimisht brenda taveaneve të miratuara.
- Në rastet kur Tavanet e Programit Buxhetor Afatmesëm nuk përmbushin nevojat më të domosdoshme, atëherë Njësitë e Qeverisjes Qendrore mund të paraqesin Kërkesa Shtesë vetëm për vitin 2015, sipas procedurës përkatëse në Shtojcën nr.5 bashkëlidhur Udhëzimit nr.8 datë 29.03.2012 “Për Procedurat Standarte të Përgatitjes së Programimit Buxhetor Afatmesëm”.
- Ndëshkimet e parashikuara në nenin 71 të Ligjit nr.9936 datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë” zbatohen për nëpunësit autorizues në çdo rast të mosrespektimit të Udhëzimit nr.8 datë 29.03.2012 “Për Procedurat Standarte të Përgatitjes së Programimit Buxhetor Afatmesëm” dhe të këtij Udhëzimi Plotësues.

- Kurset e Këmbimit për vitet 2008-2014 dhe parashikimi për vitet 2015-2017 që do të përdoren në planifikimin e shpenzimeve për projektet me financim të huaj, jepen si më poshtë:

Nr	Monedhat	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017
1	Kurs i këmbimit mesatar lek/USD	83.9	95	103.9	100.9	108.2	106	106	106	106	106
2	Kurs i këmbimit mesatar lek/EURO	122.8	131.6	137.7	140.5	139	140.3	140	140	140	140

3. Pasqyrat Plotësuese të Buxhetit Vjetor

- Të gjithë Njësitë e Qeverisjes Qendrore, në **Fazën II** të Programit Buxhetor Afatmesëm, krahas raporteve standarte të kërkesave buxhetore duhet të ri-plotësojnë dhe dorëzojnë në Ministrinë e Financave pasqyrat plotësuese të projektbuxhetit vjetor 2015 sipas **Shtojcës 1/A, të udhëzimit nr.7, datë 28.02.2014, në përputhje me tavanet e rishikuara.**

4. Seancat Dëgjimore me Njësitë e Qeverisjes Qendrore

- Përkatësisht, gjatë periudhës **18-30 Shtator 2014** (sipas Tabelës nr.2 të Udhëzimit nr.7, datë 28.02.2014 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2015-2017”), Ministria e Financave në bashkëpunim me Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Departamentin e Programimit, Zhvillimit dhe Financimeve dhe Ndhmës së Huaj pranë Këshillit të Ministrave dhe Ministrinë e Integritimit, zhvillon seancat dëgjimore me secilën njësi të qeverisjes qendrore, gjatë të cilave diskutohen kërkesat e rishikuara të Programit Buxhetor Afatmesëm 2015-2017.

5. Ndjekja e Procesit të Programit Buxhetor Afatmesëm 2015-2017 dhe Mbështetja Këshillimore

- Ndjekja dhe zbatimi me përpikmëri e këtij Udhëzimi nga ana e Njësive të Qeverisjes Qendrore do raportohet rregullisht nga Ministri i Financave në Komitetin e Planifikimit Strategjik, dhe Këshillin e Ministrave.
- Ministria e Financave, në kuadër të mbështetjes këshillimore për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2015-2017, vë në dispozicion të Njësive të Qeverisjes Qendrore adresën email: budget.programming@minfin.gov.al.
- Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, në kuadër të mbështetjes këshillimore për përgatitjen e projekt-propozimeve të investimeve publike, vë në dispozicion për çdo Njësi të Qeverisjes Qendrore adresën e-mail: investimet@ekonomia.gov.al

Shkëlqim CANI

MINISTËR